



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 100/13
Prishtinë, më 27.03.2013, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadergjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontic, Hasime Krasniqi, Hykmete Bajrami, Sali Asllanaj, Albana Fetoshi, Sevdije Lama dhe Xhevdet Neziraj.

Munguan: Latif Gashi dhe Duda Balje.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Luljetë Krasniqi, Dashurije Canolli, Arbëresha Kosumi (praktikante).

Gjithashtu ishin të pranishëm: Ramadan Avdiu Zv. Ministër i Financave, Lulzim Rafuna nga MF, monitorues ng Zyra Presidentes, KDI/TIK, gazetar nga Kosova Sot, Kosova Info.

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadergjonaj, Kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, dt. 20.03.2013;**
3. **Shqyrtimi i Vendimit të Presidentës për kthimin e Ligjit për mallrat e liruar nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor;**
4. **Miratimi i Raportit me rekomandime për Projektligjin për tarifën e veçanta të akcizës për prodhimin fillestar dhe prodhimin e vogël të produkteve alkoolike të prodhuara në Kosovë;**
5. **Shqyrtim i Raportit me rekomandime të grupit punues të Komisionit për buxhet dhe financa lidhur me projektligjin Nr.04/L-150 për odat e profesionistëve shëndetësor dhe amendamenteve të Komisionit funksional;**
6. **Shqyrtimi i Projektligjit nr.04/L-186 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për inspektoriatin dhe mbikëqyrjen e tregut me amendamentet e Komisionit Funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Induturi;**
7. **Të ndryshme.**

1. **Miratimi i rendit të ditës**

Kryetarja konstatoi se rendi i ditës miratohet pa ndryshime.

2. **Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtura e Komisionit, dt. 20.03.2013**

Kryetarja konstaton se procesverbali miratohet pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Vendimit të Presidentës për kthimin e Ligjit për mallrat e liruar nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor

Kryetarja theksoi se komisioni e ka shqyrtuar projektligjin dhe ka hartuar amendamentet të cilat janë proceduruar në komisionet tjera kryesore të cilat nuk kanë pasur vërejtje. Po ashtu projektligji me amendamente është miratua edhe në Kuvend. Mirëpo Presidentja me një vendim e ka kthyer edhe ka shpreh opinionin e saj lidhur me nenin 4 dhe ka kërkuar që të rregullohet gjuha e hartimit të këtij neni, ndërkaq nuk ka pasur vërejtje për nenet tjera të ligjit.

Ramadan Avdiu sa i përket nenit që është kontestuar nga Presidentja, konkretisht aneksit që parashihen lirimet doganore, qëllimi është të favorizohen bizneset dhe është lënë mundësia që ajo të shikohet periodikisht në mënyrë që të shikohet mundësia e lirimit të ndonjë artikulli nga obligimet doganore sepse ka biznese që mund të startojnë me lëndë të reja dhe me lëndë të para. Mënyra si është propozuar ky nen është për të mos marrë kohë procedurat e plotësim-ndryshimit të ligjeve për qëllimet e përmendura, që janë në favor të bizneseve.

Naser Osmani kur e kemi bërë ligjin kemi pas një qëllim që të funksionoj një koordinim sa më i mirë i institucioneve dhe në praktik kjo ka funksionuar me mirë me ligjin për tatimin e akcizës. Lidhur me propozimin që të thuhet Qeveria me akt nënligjor të ndryshojë aneksin është e njëjta gjë siq ka qenë te neni. Por me që në praktikë ka funksionuar mirë me ligjin e përmendur, mund të shkoj edhe ky variant që Qeveria me akte nënligjor me konsultim me komisionin për buxhet e financa të mund të ndryshojë përbërjen e aneksit e ligjit.

Hykmete Bajrami unë nuk po shoh ndonjë ndryshim në mes nenit 4 dhe propozimit që po bëhet tani përmes akt nënligjor, pasi që prap po mbetet mundësia që Qeveria të ndryshojë aneksin që është pjesë e ligjit dhe kjo nuk mund të ndryshohet pa shkuar në Parlament, kjo është edhe vërejtja e Presidentes. Po mendoj është e nevojshme që të bëhet një ndryshim substancial i nenit 4 në mënyrë që të mos na kthehet prap nga ana e Presidentes. Ne po bëjmë ndërhyrje të ligjeve gjatë gjithë kohës dhe nëse mendon që qeveria me shtue listën e produkteve, kjo do të duhej të bëhet sipas procedurës së rregullt për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit dhe kjo duhet të bëhet nga Kuvendi dhe jo të mbetet që vetëm me një konsultim me Komisionin për Buxhet dhe Financa, sepse Qeveria pastaj mund të iu bëjë favore bizneseve të caktuara.

Lulzim Rafuna sqarime pse është propozuar me akt nënligjor ka të bëjë me faktin se edhe rregullorja e Qeverisë kërkon konsultime me biznesin dhe palët tjera të interesit, kur merren iniciativa të tilla. Ankesi është pjesë e ligjit për të krijuar efekt juridik. Qëllimi është që të shkurtohen procedurat për ndryshimin e listës të produkteve kur kërkohet dhe krejt kjo në favor të bizneseve, tërheqjes së investimeve të huaja dhe lirimit të lëndëve të para. Megjithatë ky projektligj do të fillojë të humb efektin e vet pasi që Kosova po hyn në marrëveshje të Tregtisë së Lirë me Turqinë dhe shumë shpejt do të finalizohet marrëveshja edhe me BE-në. Kjo mënyrë e ndryshimit të aneksit funksion të kodi doganor dhe i akcizave, ligji i TVSH-së. Në shumë vende i kanë proceduarat shumë të shkurtëra në rastet kur kërkohet të importohen lëndet e para apo në përgjithësi investimet e huaja.

Sali Asllanaj mendoj që në rast se kërkohet fleksibilitet i duhur që është në funksion të bizneseve, do të jem në përkrahje të propozimit që përmes konsultimit me komisionin për buxhet e financa të mund të ndryshohet aneksi.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Komisioni me shtatë votë Për (Safete Hadergjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontic, Hasime Krasniqi, Sali Asllanaj, Xhevdet Neziraj, Sevdije Lama), një Kundër (Albana Fetoshi), një Abstenim (Hykmete Bajrami) nxori këtë

Rekomandim

1. I rekomandohet Kuvendit të miratojë amendamentin për ndryshimin e nenit 4 të Ligjit Nr. 04/L-163 për mallrat e liruar nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor, si në vijim:

Amendamenti 1

Neni 4

Ndryshimi dhe plotësimi i Aneksit

Në raste të veçanta Qeveria e Republikës Kosovës, me akt nënligjor, në konsultim me Komisionin për Buxhet dhe Financa të Kuvendit të Republikës së Kosovës, mund të ndryshojë përbërjen e Aneksit 1 të këtij Ligji.

4. Miratimi i Raportit me rekomandime për Projektligjin për tarifatat e veçanta të akcizës për prodhimin fillestar dhe prodhimin e vogël të produkteve alkoolike të prodhuara në Kosovë

Kryetarja edhe lidhur me këtë projektligj është neni 4 që e rregullon qështjen e ndryshimit të aneksit A dhe B sikures të ligji mëparshëm. Mendoj që edhe këtu mund të prozojmë që Qeveria me akt nënligjor pas konsultimit me KBF të mund të ndryshojë shtojcën A dhe B të ligjit.

Alban Fetoshi unë mendoj se Kuvendi është institucioni që mund të bëjë ndryshime dhe jo Qeveria. Sikurse edhe me ligjin e mëparshëm nuk po mendoj se është nevojshëm dhe e mjaftueshme vetëm Qeveria dhe komisioni të mund të bëjnë këtë ndryshim.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Komisioni me shtatë votë Për (Safete Hadergjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontic, Hasime Krasniqi, Sali Asllanaj, Xhevdet Neziraj, Sevdije Lama), Një Kundër (Albana Fetoshi), një Abstenim (Hykmete Bajrami) nxori këtë

Rekomandim

- I. Neni 4, ndryshohet si në vijim:

Neni 4

Ndryshimi dhe plotësimi i Shtojcës

Në raste të veçanta Qeveria e Republikës Kosovës me akt nënligjor në konsultim me Komisionin për Buxhet dhe Financa të Kuvendit të Republikës së Kosovës, mund të ndryshojë përbërjen e Shtojcës A dhe Shtojcës B të këtij Ligji.

- II. Raporti me rekomandime procedohet për shqyrtim dhe miratim në seancë plenare.

5. Shqyrtim i Raportit me rekomandime të grupit punues të Komisionit për buxhet dhe financa lidhur me projektligjin Nr.04/L-150 për odat e profesionistëve shëndetësor dhe amendamenteve të Komisionit funksional

Kryetarja njoftoi se grupi punues ka mbajtur disa takime dhe ka qenë vështirë të gjindet një zgjidhje në qështjet e financimit dhe buxhetit të odave të profesionistëve, pasi që statusi i këtyre odave është paraparë të jenë organizata të pavarura. Po ashtu ka qenë e vështirë të harmonizojm me legjislacioni aktual, pasi që statusi i këtyre odave është si organizata të pavarura që parashihen të financohen tri vjet nga buxheti i Kosovës, pastaj të vetfinancohen. Po ashtu ka qenë vështirë të përcaktohet edhe mënyra e raportimit financiar të tyre. Ne kemi punuar shumë si grup punues dhe ajo qfarë kemi bërë janë propozim amendamentet që i keni para jush.

Naser Osmani një qeshje mjaft delikate që është para neve, në këtë situatë komisioni ose duhet ndërhyrë në qeshjen e financave që e prek strukturën e draftit apo të rekomandoj kthimin e ligjit mbrapa. Arsyeja sipas mendimit tim që gjatë hartimit të këtij ligji nuk është marrë për bazë funksionimi i sistemit financiar në Kosovë. Unë mendoj që këto oda nuk mund të kenë pavarësi financiare. Pajtohem që këto oda të kenë pavarësi profesionale në kryerjen e veprimtarisë por asnjë institucion publik në Kosovë nuk duhet të shmanget mundësisë së kontrollit nga auditimi dhe të gjitha mjetet duhet të kalojnë përmes thesarit.

Xhevdet Neziraj na e dimë se muajin e fundit i kemi disa projektligje me kosto buxhetore shtesë. Meqë këto ligje kalojnë në qeveri për miratim dhe aty janë të pranishëm ministrat, në këtë rast edhe ministri i financave edhe ai i shëndetësisë, do të duhej që atje të bisedoheshin këto qështje dhe në rast se kemi këso probleme të mos vijnë në komision të buxhetit.

Hykmete Bajrami kam një pyetje zv. ministrin se në qeveri kur të votoni qysh kaloni projektligji kur nuk ju përmbahet standardeve të sistemit financiar. Ne nuk jemi komision funksional dhe nuk mundemi me kthye ligjin, por nëse duhet me ndryshu duhet me e përshtat statusin e odave ekonomike shëndetësore me mënyrën e financimit dhe kjo të rregullohet me dispozita kalimtare. Në kohën sa financohen nga buxheti i Kosovës të kenë një status tjetër edhe deri në momentin kur pavarësohen të kalojnë si të pavarura në mënyrë që të mos ndërhyjnë në sistemin financiar.

Sali Asllanaj në grup punues nuk kemi mundur të gjejm zgjidhje edhe pse kemi punuar shumë. Unë kam qenë prej atyre të paktëve optimist në përkrahje të reformave të filluar në shëndetësi dhe jam akoma përkrahës i fuqishëm i asaj që të ndërmarrin dhe ndryshojnë diçka në shëndetës, por punët nuk po shkojnë mirë dhe i dijmë problemet me ligjin për shëndetësi. Rasti i këtij projektligji që po bisedojmë tregon një punë katastrof të qeverisë që e ka sjellur këtë në parlament dhe filluar një proces pa vullnet të madh politik. Odat e profesionistëve shëndetësor i kam kuptuar me iden e pavarësimin nga politika. Por problemi është siç u theksua se qfarë do të bëhet pas tri vjetesh kur nuk do të financohen nga buxheti i Kosovës dhe nuk do të ketë mbikëqyrje institucionale. Por megjithatë po të kishte vullnet politik ne do të trajtonim në kuadër të reformave shëndetësore dhe pse jo edhe të ndryshohet LMFP për t'iu përshtatur këtyre reformave.

Ramadan Avdiu deklarata e Ministrisë së Financave është që të gjitha të hyrat në zbatimin e këtij ligji janë të hyra publike dhe duhen trajtuar në pajtim me LMFP. Unë kam bërë përpjekje të kontaktoj ministrin e shëndetësisë dhe të sugjeroj tërheqjen e projektligjit pasi që ka nevojë për ripërpunim dhe harmonizim me legjislacionin aktual por nuk ka pasur vullnet. Por sido që të kalojë pjesa financiare, duhet të trajtohet në pajtim me Ligjin për menaxhimin e financave publike pasi që ai ligj dominon mbi të gjitha ligjet në këtë aspekt.

Kryetarja edhe pse si grup punues i kemi bërë disa rekomandime, nga diskutimit që po dalin këtu po duket që nuk ka harmonizim, por në leximin e dytë është pak problem të kthehet projektligji. Unë e shoh se edhe nga takimet që i kemi pas me ministrin e shëndetësisë është pak problem me e gjetë ndonjë zgjidhje tjetër duke e pasur parasysh draftin siç është hartuar.

Naser Osmani sugjeroj që grupi punues të vazhdoj punën edhe pak dhe le të kërkohet një zgjidhje për këtë projektligj.

Hykmete Bajrami ne ndoshta mundemi të rregullojmë që këto oda të kenë pavarësinë në aktivitetin e tyre por jo edhe në pjesën financiare. Të trajtohen sikurse edhe organizatat tjera buxhetore të pavarura dhe të gjitha të hyrat të derdhen në thesar.

Pas diskutimeve, Komisioni njëzëri nxori këtë

Përfundim

Grupit punues të vazhdojë punën në shqyrtimin e projektligjit për odat e profesionistëve dhe të dal me rekomandime për miratim në komision.

6. Shqyrtimi i Projektligjit nr.04/L-186 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për inspektoriatin dhe mbikëqyren e tregut me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Indsutri

Kryetarja sa i përket këtij projektligji është neni 10 që parasheh qështjen e shtesave për inspektoret e tregut, të cilët janë shërbyes civil dhe këto të drejta mund ti gëzojnë në pajtim me ligjet e shërbimit civil dhe rregulloreve që nxjerren për zbatimin e tyre.

Ramadan Avdiu në pajtim me ligjet për shërbimin civil, janë nxjerrur një numër rregulloresh nga ministria e administratës publike që përcaktojnë qështjen e kompensimeve dhe shtesave dhe kjo do të rregullohet brenda rregullatives ligjore në fuqi.

Kryetarja po më duket se kjo qështje është e rregulluar sipas ligjeve në fuqi dhe mendoj qe ne mund ta kalojm siç është propozuar.

Pas diskutimeve, Komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për inspektoriatin dhe mbikëqyren e tregut me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL nuk përmbajn implikime buxhetore shtesë.

7. Të ndryshme

7.1. Kryetarja njoftoi anëtarët me kërkesën e Komisionit të Pavarur për Media për mbajten e një takimi të përbashkët me Komisionin për Buxhet dhe Financa për të diskutuar për qështjet e financimit të KPM-së dhe bordit të ankesave. Ju e dini se më herët Komisioni i Pavarur për Media ka dërguar një shkresë ku ka kërkuar shtesa jashtë atij kompensimi i cili i është caktuar nga Kuvendi dhe ne e kemi trajtuar dhe iu kemi përgjigjur se Kuvendi me vendim ka caktuar kompensimin për anëtarët e KPM-së dhe të bordit të ankesave që është i vlefshëm deri në miratimin ligjit për pagat e funksionarëve të lartë publik.

Ramadan Avdiu për sa jam informuar unë, KPM-ja ka kërkuar që të sqarohet qështja se ata marrin kompensime dhe jo paga, pasi që që kanë të drejtë të punojnë edhe dikun tjetër dhe të mos kenë problem me paga.

Kryetarja ata le të interpretoj si te dojnë, por vendimi është i marren si kompenzim për punën te cilën e bëjnë siq e përcakton ligji.

Hykmete Bajrami në rast se situata është kështu siç po e paraqitet, vlerësoj se nuk kemi nevojë të mbajm një takim shtesë por mundemi me iu përgjigjur se e kemi trajtuar këtë qështje me një shkresë dhe sqaruar se Kuvendi ka përcaktuar kompensimet e tyre.

Pas diskutimeve, Komisioni njëzëri nxorri këtë

Përfundim

Komisioni për Buxhet dhe Financa, vlerëson se Kuvendi në pajtim me Ligjin për KPM-në sipas rekomandimit të Komisioni ka caktuar nivelin e kompensimit mujor për kryetarin dhe anëtarët e Komisionit të Pavarur për Media dhe kryetarin dhe anëtarët e Bordit të Ankesave, i cili është i vlefshëm deri në miratimin e Ligjit për Pagat e Zyrtarëve të Lartë Publik. Si rrjedhojë, Komisioni e vlerëson të panevojshëm mbajtjen e një takimi të përbashkët në mes Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe Komisionit të Pavarur për Media për të diskutuar për këtë qështje.

7.2. Kryetarja theksoi se Sekretari i Kuvendit na ka njoftua me një vendim të Qeverisë për ndarjen e 200.000 eurove nga shpenzimet e paparashikuara për RTK-në në emër të blerjes së paisjeve për kanalin e dytë në gjuhën serbe. Mendoj që vendimi si i tillë nuk ka pas nevojë të vijë në komision, pasi që mjetet janë ndarë nga rezervat dhe nuk e di pse duhet ta trajtojmë si qështje.

Ismet Krasniqi qështja është shumë teknike, pasi që buxheti i RTK-së është pjesë e buxhetit të Kuvendit. Duke ditur mënyrën e ndarjes së buxhetit përmes rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa deri më tani, prandaj e kemi sjellur tek komisioni.

Sali Asllanaj e kundërshtoj këtë alokim të mjeteve për RTK. Me ligjin e ri është paraparë mënyra e financimit të RTK-së, përfshirë edhe ndarje e mjeteve për kanalin në gjuhën serbe dhe qfarë do financimi tjetër shtesë, konsiderohet një ndërhyrje e qeverisë në këtë medium publik.

Alban Festoshi kërkesa është shabllon dhe nuk kemi detalizime dhe si të tillë nuk duhet përkrahur.

Ramadan Avdiu njoftoi se ka qenë një kërkesë permanente e RTK-së për ndarje të mjeteve shtesë për blerje të paisjeve për programin e dytë të gjuhës serbe dhe qeveria nga rezervat buxhetore ka ndarë 200,000€ dhe e ka dërguar në Kuvend, pasi që RTK është pjesë e buxhetit të Kuvendit.

Sali Allanaaj mënyra si është proceduar në Kuvend është e paligjshme dhe vlerësoj se ne nuk kemi qfarë të dikutojmë për këtë qështje.

Naser Osmani në rast se qeveria i ka ndarë mjetet prej rezervës buxhetore, le t'ia alokojë drejtëpërdrejtë RTK-së. Ndërkaq nëse është proceduar si propozim-vendim nga Qeveria për të bërë destinime të mjeteve ne mund të trajtojmë si Kuvend. Duhet sqaruar vendimin e saktë të qeverisë.

Kryetarja e citoj vendimin e qeverisë. Arsyej pse është sjellur këtu sa kuptova është se duhet shkuar përmes Kuvendit sepse RTK është program brenda buxhetit të Kuvendit. Me qenë se ne si komision kemi kërkuar me na njoftuar për çdo detaj RTK-ja, për shpenzimet e për planifikimin, prandaj edhe sekretari e ka dërguar në komision për të na informuar.

Naser Osmani kërkesa prej Kuvendit nuk ka shkuar dhe këtu nuk kemi mjete të rregullta, të planifikuara për veprimtarin e RTK-së, por mjete të jashtëzakonshme nga rezervat buxhetore dhe pse ne me ndërhy në kompentecat e qeverisë dhe pse po kërkohet që parlamenti me mbulue këtë qështje.

Albana Fetoshi nëse nuk është marr paraprakisht ndonjë veprim prej Kuvendit, nuk besoj që duhet tani Kuvendi me i vazhduar procedurat. Jam plotësisht e bindur madje që Kryeministri nuk ka të drejtë me na sjellur këtu vendime si njoftime dhe në praktikën e deri tashme nuk ka ndodhur kështu .

Pas diskutimeve, Komisioni me pesë vota Për (Safete Hadergjonaj, Jelena Bontic, Hasime Krasniqi, Sevdije Lama dhe Xhevdet Nezira) Tri kundër (Hykmete Bajrami, Sali Asllanaj dhe Albana Fetoshi) , dhe një Abstenim (Naser Osmani) nxori këtë

Rekomandim

1. Ministria e Financave dhe Administrata e Kuvendit të Kosovës të respektojnë procedurat për ndarjen e mjeteve financiare në vlerë prej 200,000.00 (dyqind mijë) euro nga Rezerva Qeverisë – shpenzimet e paparashikuara, në xhirollogarinë e Radio Televizionit të Kosovës, për blerjen e teknikës për studio për programin e dytë të RTK-së në gjuhën serbe, sipas Vendimit të Qeverisë së Kosovës nr.15/115 dt. 13.02.2013.

Mbledhja përfundoi: 12:10

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Safete Hadergjonaj